

PËRDORIMI I VIDEOS NË FORMIMIN DHE ZHVILLIMIN E MËSUESVE



PËRMBAJTJA

RRETH MANUALIT.....	3
---------------------	---

PËRDORIMI I VIDEOS NË FORMIMIN DHE ZHVILLIMIN E MËSUESVE

.....	4
Kapitulli 1: Përgatitja për të përdorur Kamerën.....	4
Kapitulli 2: Përgatitja për Vëzhgimin dhe Reflektimin në lidhje me Videon.....	5
Kapitulli 3: Reflektimi mbi Praktikën e Përdorimit të Videos.....	7
Kapitulli 4: Videot Demonstruese dhe Mikro-Mësimet.....	9
Kapitulli 5: Vizioni Profesional.....	12
Kapitulli 6: Prodhimi i Videove dhe Krijimi i Video-Bibliotekës...	13

Ky manual elektronik u krijua për të promovuar përdorimin e videos në arsim dhe në veçanti, përdorimin e video- pedagogjisë, si në kualifikimin fillestar të mësuesve ashtu edhe në zhvillimin e vazhdueshëm të tyre si mësues.

Shembujt e këtij manuali synojnë të shërbejnë si mjete praktike që mund të zbatohen në nivele dhe fusha të ndryshme të arsimit.

Edhe pse videot janë përdorur për dekada të tëra në arsim dhe formim, teknologjia e përparuar, të nxëniet nëpërmjet internetit dhe pedagogjia digjitale i kanë rritur mundësitë dhe rolin e videos në procesin mësimor. Zakonisht si mësuesit ashtu edhe nxënësit mbajnë me vete në shumicën e kohës një pajisje të fuqishme - telefonin inteligjent, por shpesh ai nuk përdoret me të gjithë potencialin e tij. Gjatë viteve të fundit, programet për trajnimin e mësuesve në të gjithë botën janë fokusuar dhe e kanë përshtatur përdorimin e videos në funksion të praktikave pedagogjike.

Megjithatë, ka shumë mësues dhe trajnues të mësuesve që nuk e kuptojnë mënyrën apo arsyen e përdorimit të videos si pjesë e zhvillimit profesional të mësuesve. Ky është qëllimi i këtij libri elektronik: të ofrojë ushtrime praktike që do t'u japin mundësi mësuesve dhe trajnuesve të mësuesve që të përdorin videon në zhvillimin profesional. Kapitujt fillestarë përqendrohen te përdorimi i videos në zhvillimin profesional të mësuesve ndërsa kapitujt e mëvonshëm ilustron mënyrën se si materialet filmike (video) mund të përdoren nga vetë mësuesit në mësimdhënie.

Secili kapitull fillon me detyra mësimore. Detyrat kërkojnë përfshirjen tuaj të drejtpërdrejtë në veprimtari reale. Për të bërë të mundur një gjë të tillë, do t'ju nevojiten disa mjete teknike si telefonat inteligjentë, një kompjuter, një kamera dhe një program kompjuterik për modifikimin e materialit filmik. Për disa nga këto detyra do t'ju duhet të punoni në çift ose në një grup të vogël. Ne i inkurajojmë përdoruesit e këtij manuali elektronik që të krijojnë materialet e tyre. Mos u shqetësoni shumë dhe mos kritikoni veten për cilësinë e videove tuaja. Qëllimi nuk është prodhimi i materialeve filmike me cilësi komerciale. Rezultati i synuar i të nxëniet është që të mësoni sa më shumë në lidhje me videot dhe t'i përdorni ato siç duhet për qëllime pedagogjike, gjë që i ndihmon mësuesit me të vërtetë.

Pas detyrave mësimore do të gjeni disa shënime të shkurtra në lidhje me detyrat dhe gjërat që duhet të keni parasysh. Linqet e dhëna në tekst lidhen me videot në internet ose me vendndodhje të tjera në internet. Prandaj, është e mundur që me kalimin e kohës, disa nga burimet nuk do të jenë më në dispozicion.

Manuali nuk hyn në detaje sa i takon informacionit teknik në lidhje me mjetet, formatet dhe programet e ndryshme kompjuterike. Spektri i mjeteve, formateve dhe programeve kompjuterike që lidhen me materialet filmike (video) ndryshon vazhdimisht - diçka që është në dispozicion falas tani në këtë moment, mund të mos jetë e disponueshme pas një viti.

Standardet mund të ndryshojnë dhe mjetet mund të vihen më shumë ose më pak në dispozicion. Ne ju rekomandojmë të kërkonti mjete të reja dhe të përshtatshme - dhe të provoni mjete të ndryshme për të mësuar se çfarë ju përshtatet më së miri. Të guxosh duke provuar përdorimin e mjeteve të reja është një mënyrë e shkëlqyeshme për të mësuar!

Ky manual bazohet në punën praktike, kërkimin dhe zhvillimin e video-pedagogjisë nga **Universiteti Oulu i Shkollës për Shkencat e Aplikuara në Arsimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Instituti Federal Zviceran për Arsimin dhe Formimin Profesional**.

Këto burime të video-pedagogjisë mund të gjenden në faqen e internetit të Fondacionit European të Trajnimit. Ju lutemi bëhuni pjesë e [Komunitetit të ETF për video-pedagogjinë](#).

Fondacioni European i Trajnimit www.etf.europa.eu

Twitter [@vidpedagogy #videopedagogy](#)

[Oulu University of Applied Sciences School of Professional Teacher Education](#) (Universiteti Oulu i Shkollës për Shkencat e Aplikuara në Arsimin Profesional të Mësimdhënësve)

[Swiss Federal Institute for Vocational Education and Training](#) (Instituti Federal Zviceran për Arsimin dhe Formimin Profesional)

Ky udhëzues u përgatit nga Janne Länsitie, Juha Pousi dhe Tommi Karjalainen nga Universiteti Oulu i Shkollës për Shkencat e Aplikuara në Arsimin Profesional të Mësimdhënësve, Finlandë, me rishikime nga Julian Stanley, ekspert i ETF, dhe redaktimin e Denise Loughran, ETF. Ai u përgatit në kuadrin e një projekti më të gjerë për video-pedagogjinë, për zbatimin e të cilit ETF ngarkoi Universitetin e Oulu të Shkencave të Aplikuara në Finlandë (ref. Bler Stevenson dhe Janne Länsitie) dhe SFIVET (ref. Alberto Cattaneo dhe Alessia Evi-Colombo).

Ju lutemi citoni si më poshtë:

Länsitie, J., Pousi, J., Karjalainen, T. & Stanley, J. (2019). Përdorimi i videos në formimin dhe zhvillimin e mësuesve. Fondacioni European i Trajnimit: Torino.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësia e vetme e autorëve dhe e ETF dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve të BE-së.

PDF ISBN 978-92-9157-709-5 doi:10.2816/104500
TA-01-19-495-EN-N

© Fondacioni European i Trajnimit, 2019.

Teksti
**JANNE LÄNSITIE
JUHA POUSI
JULIAN STANLEY
TOMMI KARJALAINEN**

Dizajni
TOMMI KARJALAINEN

PËRDORIMI I VIDEOS NË FORMIMIN DHE ZHVILLIMIN E MËSUESVE

KAPITULLI 1: PËRGATITJA PËR TË PËRDORUR KAMERËN

Ky kapitull ju ndihmon të filloni punën për krijimin e materialeve filmike (video) dhe ju informon se ku mund t'i gjeni mjetet dhe ndihmën që ju nevojitet.

Detyrë mësimore 1.1: Prezantoni veten tuaj me një video

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- krijoni një video për veten tuaj
- performoni para kamerës
- punoni në çift

Le të fillojmë me elementet bazë. Për të paraqitur informacionin kryesor për veten tuaj para kamerës ju nevojitet një pajisje regjistrimi për materialet filmike. Ju duhet të regjistroni si me zë ashtu edhe me figurë (audio dhe video). Cilësia konsiderohet e mirë atëherë kur shikuesi mund t'ju shohë dhe t'ju dëgjojë qartë. Mos u shqetësoni shumë për cilësinë profesionale të videove tuaja të para. Qëllimi është që të vendosni një standard në atë pikë që iu mundëson juve ose ndonjë mësuesi tjetër që të filloni të përdorni videon si një mjet për mësimdhënie dhe zhvillim personal. Ju nuk po synoni të arrini nivelin e filmave profesionalë apo prodhimeve televizive cilësore. Po ashtu, nuk duhet të krahasoni aftësitë tuaja performuese me aktorët profesionistë ose prezantuesit televizivë.

Kërkojini kolegët ose mikut tuaj t'ju ndihmojë duke kryer rolin e operatorit. Tregojini operatorit tuaj si funksionon kamera juaj (ose telefoni inteligjent) dhe çfarë lloj video dëshironi. Ndihmojeni atë të regjistrojë prezantimin tuaj ashtu si dëshironi. Mbajeni kamerën ose telefonin inteligjent në mënyrë horizontale!

Gjërat që duhen patur parasysh

Fillimi është shpesh gjëja më e vështirë. Ne rekomandojmë që aktiviteti mësimor të fillojë menjëherë - në këtë rast duke bërë një video shumë të thjeshtë pa elementë të shtuar. Këtu mësuesi mund të përjetojë procesin e krijimit të materialeve filmike brenda pak minutash.

Ju nuk keni nevojë të përdorni mjete të shtrenjta profesionale për të bërë video me cilësi të mirë. Telefonat inteligjentë prodhojnë video me cilësi mjaft të mirë të cilat mund të përdoren në internet. Është me doli që të mësoni si të përdorni të gjitha mjetet e përditshme që keni në mënyrë që të jeni në gjendje të ndihmoni nxënësit që të përdorin çfarëdo lloj pajisjeje regjistrimi që kanë në dispozicion të tyre.

Rishikimi i veprimeve tuaja në video nuk është një detyrë e lehtë. Shpesh jemi shumë kritikë ndaj vetvetes. Është shumë normale që në fillim të mos ndjeheni të kënaqur, por do ta kapërcëni atë. Ju ndoshta performoni më mirë, tingëlloni dhe dukeni më mirë sesa mendoni!

Mos hezitoni të reregjistroni sekuencat. Nëse belbëzoni ose bëni gabime, nuk ka problem. Mund ta provoni përsëri dhe të reregjistroni sekuencat.

Shembull i një video-prezantimi shumë të thjeshtë: [Fjalim Vetë-Prezantues prej Dy Minutash](#).




Figura 1. Mund të përdorni një telefon inteligjent për regjistrimin e videos.



Figura 2. Një shembull i inkuadrimin dhe përdorimit të një trekëmbëshi.

VIDEO-
PREZANTIMI

KAPITULLI 2: PËRGATITJA PËR VËZHIMIN DHE REFLEKTIMIN NË LIDHJE ME VIDEO

Ky kapitull ju kërkon të mësoni në lidhje me mjetet për krijimin e materialeve filmike (video).

Detyrë mësimore 2.1: Zgjidhni mjetet e duhura

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- mësoni se si të punoni me pajisjet regjistruese që keni në dispozicion
- gjeni pajisjet e disponueshme në organizatën tuaj
- mësoni se kush mund t'ju ndihmojë në përdorimin e videos

Zbuloni

- Ku janë pajisjet në shkollën / organizatën / vendin tuaj të punës?
- Kush është përgjegjës për ta?
- Kush mund t'ju ndihmojë për marrjen e mjeteve dhe trajnimin për mënyrën e përdorimit të tyre?
- A ofrohen programe kompjuterike redaktimi dhe shërbime *cloud* nga shkolla ose vendi i punës?

Gjërat që duhen patur parasysht

Zakonisht organizatat arsimore kanë njerëz që janë përgjegjës për pajisjet teknike. Ata ndoshta dinë më shumë për teknologjinë e informacionit (TI), pajisjet audio-vizuale, videon, kabllo dhe energjinë elektrike sesa shumica e mësuesve apo nxënësve. Ia vlen të përdorim ekspertizën e tyre. Personeli teknik mund t'ju ndihmojë nëse keni nevojë të blini mjete të reja për organizatën.

Ndoshta ekziston edhe një shërbim huazimi për pajisjet audio-vizuale. Nëse personeli mbështetës ose teknik nuk është i disponueshëm, ndoshta mund të gjeni një koleg tjetër që është i informuar në lidhje me këto çështje.

Për krijimin e materialeve filmike planifikimi dhe përgatitja janë thelbësore pasi ndihmojnë për të kursyer kohën. Në momentin që ka filluar aktiviteti i cili po regjistrohet, është mjaft e vështirë të filloni rregullimin e problemeve me mjetet tuaja. Me anë të planifikimit ju do të kurseni kohën e gjithësecilit. Puna në ekip është thelbësore. Mësoni të dalloni dhe të punoni me njerëz, aftësitë e të cilëve janë plotësuese dhe të dobishme për një video-projekt. Puna së bashku për një video-projekt zhvillon edhe aftësitë bashkëpunuese.

Detyrë mësimore 2.2: Regjistroni veprimtarinë tuaj mësimdhënëse

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- vendosni pajisjen e regjistrimit në mjedisin mësimor
- përgatiteni për video-dokumentimin e veprimtarisë mësimdhënëse
- regjistroni një aktivitet mësimdhënës për reflektim ose vlerësim

Zgjidhni një situatë të veçantë gjatë mësimdhënies të cilën dëshironi ta regjistroni. Për shembull - një udhëzim i shkurtër në lidhje me një detyrë mësimore të një nxënësi.

Planifikoni mënyrën e vendosjes së pajisjeve në mënyrë që si zëri ashtu edhe figura (audio dhe video) të mund të fiksojnë materiale të mjaftueshme me cilësinë e duhur. Regjistroni veprimtarinë mësimdhënëse. Vëzhgoni videon për tu njohur me praktikën tuaj të mësimdhënies. Mbani shënime në lidhje me mënyrën tuaj të mësimdhënies.

Gjërat që duhen patur parasysht

Shpesh videoja konsiderohet si një mjet për vëzhgimin e veprimtarive mësimdhënëse të të tjerëve. Sidoqoftë, videoja mund të përdoret edhe me qëllim vetë-vëzhgimi. Në këtë rast videoja është një mjet për të dokumentuar aktivitetet mësimdhënëse të një personi dhe një ndihmë për reflektim dhe vetëvlerësim.

Videoja i ndihmon mësuesit të zhvillojnë dhe zbatojnë "vizionin e tyre profesional", që është aftësia e tyre për të perceptuar, kuptuar dhe vlerësuar sjelljen profesionale. Në të njëjtën mënyrë, edhe atletët profesionistë shpesh përdorin regjistrime në video të performancave të tyre për të përsosur aftësitë e tyre. Mësuesit përdorin në mënyrë rutine vizionin e tyre profesional kur vëzhgojnë kompetencën e nxënësve të tyre, por është më pak e zakonshme që ata të vëzhgojnë mësimdhënien. Materiali filmik (video) mund të ruhet për përdorim të mëvonshëm.

Kështu, videoja mund të përmirësojë vizibilitetin e sjelljeve të caktuara në mësimdhënie dhe të kompetencave të qenësishme duke bërë të mundur rishikimin ose shkëmbimin e praktikës.

Aktiviteti i vëzhgimit dhe reflektimit nëpërmjet videos është një mjet për të kujtuar dhe sjellë ndër mend. Rishikimi i videos mund të bëhet vetëm, i i pashoqëruar, ose me një praktikant ose një mësues tjetër.

Regjistrimi i një veprimtarie mësimore u shërben si mësuesve ashtu edhe nxënësve. Për një mësues, videoja e regjistruar mund të përdoret për reflektim dhe vëzhgim të mënyrës personale sa i takon mësimdhënies. Për nxënësit, mësimet e regjistruara mund të shërbejnë si një mundësi për të rishikuar përmbajtjen e mësimave ose veprimtarinë e tyre mësimore.

Detyra në këtë kapitull është kryesisht teknike, por në varësi të mënyrës se si do të përdoret videoja, është e rëndësishme që të kihen parasysh disa gjëra. Nëse e përdorni videon për vetë-reflektim, ju dëshironi të shihni dhe të dëgjoni aq sa duhet për të kujtuar dhe kuptuar se çfarë ndodhi. Nëse videoja përdoret për vlerësim dhe do të shikohet, për shembull, nga një trajnues i mësuesve ose punëdhënës i ardhshëm, ajo duhet të jetë sa më realiste dhe kompetente. Gjithashtu ju duhet të keni parasysh edhe se kush apo çfarë mund të filmohet. Ekzistojnë rregullore që përcaktojnë atë që mund të regjistrohet në vendet e punës dhe shkollat. Ju ndoshta do të duhet të merrni pëlqimin e nxënësve ose lejen e prindërve nëse nxënësit janë të mitur.

Çfarë pajisjesh ju nevojiten dhe cilat janë kufizimet? Mendoni për energjinë elektrike, dritat, akustikën e ambientit. Nëse nuk ju lejohej të filmoni nxënësit, gjeni mënyrën për ta vendosur kamerën në atë pozicion ku dukeni vetëm ju.

Testoni se sa larg nga kamera dhe mikrofoni duhet të flasin njerëzit për t'u siguruar që të dëgjohej në video. Po ashtu dëgjoni zërin tuaj. A është mjaftueshëm i qartë dhe i lartë për audion e videos?

Sigurohuni që zëri juaj të jetë i qartë dhe të mos ndikohet apo mbytet nga ndonjë zhurmë tjetër. Sigurohuni që videoja të regjistrojë pikërisht atë hapësirë që synoni të shfaqni në video.

Përfytyroni aktivitetin që po përpiqeni të regjistroni. Nëse duhet të shihni vetëm mësuesin, atëherë nuk është e nevojshme të shqetësoheni për të regjistruar nxënësit apo reagimet e tyre. Nëse po përpiqeni të tregoni mësimdhënien praktike të aftësive, mund t'ju duhet të përqendroheni në një plan më të ngushtë.



Figura 3. Skenari i praktikës mësimore. Kamera e vogël në të majtë po regjistron mësuesen.

Shembull i një rasti: Regjistrimi i një videoje gjatë praktikës mësimore të një mësuesi praktikant

Një kandidat për mësues në arsimin profesional është gati të fillojë praktikën mësimore në një shkollë të largët profesionale, që ndodhet qindra kilometra larg nga universiteti që ofron programin e kualifikimit të mësuesve. Qëllimi i praktikantit është që të vërë në praktikë metodat e ndryshme mësimore. Sidoqoftë, vendndodhja në distancë e shkollës ku do të zhvillohet praktika e pengon profesorin e universitetit që të vëzhgojë mësimdhënien e studentëve në mënyrë të drejtpërdrejtë. Nëpërmjet videos aktivitetet mësimdhënëse mund të regjistrohen dhe të dokumentohen duke e bërë të dukshme kompetencën e kandidatit për mësues në përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies. Kështu, kompetencat mund të rishikohen nga vetë studenti dhe të vlerësohen më vonë edhe nga profesori në universitet.

Studenti këshillohet të dokumentojë veprimtarinë mësimore me një video në mënyrë që studenti dhe profesorët të mund të rishikojnë dhe vlerësojnë punën më pas. Videoja e ndihmon procesin duke siguruar shembuj të qartë, të cilët mund të diskutohen. Videoja, gjithashtu, mund të ndihmojë edhe për t'u përqendruar në një pjesë ose veprim të caktuar që ndodhi në klasë.

Mënyrat e zakonshme për të prodhuar këto lloj materialesh filmike (video) janë, për shembull, vendosja e një kamere në një vend nga ku mund të regjistrohet sa më shumë që të jetë e mundur. Edhe angazhimi i një personi tjetër për të regjistruar klipet me një pajisje celulare mund të jetë një ide e mirë. Regjistrimi nëpërmjet një kamere në internet i aktiviteteve direkt në kompjuter ose *cloud* e bën ndarjen me të tjerët edhe më të lehtë. Madje disa salla leksionesh mund të kenë të instaluar edhe një sistem të integruar për regjistrimin e leksioneve - kështu që mësuesit i duhet të shtypë vetëm një buton për të filluar regjistrimin.

Një shembull i një mësueseje praktikante e cila e tregon aftësinë e saj duke përdorur videon: [Bëjeni Aftësinë Tuaj të Dukshme me anë të Videos](#). Ju do të shikoni se puna e mësueses praktikante është planifikuar me kujdes dhe se ajo përdor edhe telefonin e saj për të dokumentuar mësimin nga këndvështrimi i vetë nxënësve të saj.

REALIZIMI
NË
PRAKTIKË
I VIDEOVE

KAPITULLI 3: REFLEKTIMI MBI PRAKTIKËN E PËRDORIMIT TË VIDEOS

Fokusi i këtij kapitulli është reflektimi mbi veprimtarinë mësimdhënëse me ndihmën e videos. Ju mund t'i kryeni këto aktivitete vetëm, por do të përfitoni më shumë prej tyre nëse do të punoni në çift ose në grup ku do të keni mundësi për të ndarë dhe krahasuar mendimet tuaja me të tjerët.

Detyrë mësimore 3.1: Shikoni një video për të reflektuar mbi veprimtarinë mësimdhënëse

Rezultatet e të nxënës:

Ju

- reflektoni dhe zhvilloni mënyrën tuaj të mësimdhënies duke shikuar shembuj të videove të ndryshme
- analizoni dhe reflektoni për veprimtarinë mësimdhënëse të regjistruar në video

Zgjidhni një video që është e disponueshme publikisht, gjeni ose regjistroni një video që mund të përdoret për këtë detyrë. Për shembull, *TED talks* (në YouTube) janë fjalime publike të mirëmbledhura që mund të përdoren për të përgatitur leksione dhe për të zhvilluar stilin e ligjërimit. Mbani shënime ndërkohë që jeni duke ndjekur videon në lidhje me sa vijon:

- Cila është përmbajtja thelbësore? A komunikohet qartë?
- Sa shpesh dhe si i drejtohet folësi dëgjuesit?
- Si e vendos folësi kontaktin me audiencën?
- Si i përdor folësi shembujt në lidhje me përvojat e veta personale për të përçuar mendimin e tij / saj?
- Si e përdor folësi hapësirën?
- Çfarë mjetesh vizuale përdoren?

Alternativa të tjera

Bëni të njëjtën detyrë qoftë vetëm ose në çift ose me një grup të vogël. Kryejeni detyrën individualisht dhe më pas krahasoni vëzhgimet që keni bërë me të tjerët. Si të ngjashme janë rezultatet tuaja dhe ku ndryshojnë ato? Pse dolët me vëzhgime të ndryshme? Si ndikon kjo në vlerësim?

Gjërat që duhen patur parasysh

Përcaktoni fokusin tuaj në mënyrë që ta keni të qartë se çfarë po kërkon. Fokusi i kësaj detyre është që të vëzhgoni një aspekt të identifikuar të mësimdhënies dhe të shikoni se si shfaqet në video. Nëse po përdorni *TED Talks* për këtë detyrë, ka kuptim që të përqendroheni tek të folurit publik, aftësitë e prezantimit dhe stili i ligjërimit.

I njëjti fokus specifik duhet të jetë edhe qëllimi për zhvillimin tuaj personal. Duhet të theksohet se është mjaft e vështirë të vëzhgohen shumë gjëra në të njëjtën kohë - veçanërisht nëse ato shfaqen rastësisht në video. Ju do të arrini të vini re disa elemente dhe të humbisni disa të tjerë. Prandaj, rekomandohet që të përcaktoni qartë fokusin tuaj. Vëzhgimet e rastësishme do të prodhojnë rezultate kryesisht të rastësishme.

Sigurohuni që veprimtaria e caktuar mësimdhënëse të jetë e vëzhgueshme. Për shembull: ju me siguri mund të vëzhgoni me lehtësi strukturën e mësimi ose përdorimin e hapësirës nga ana e mësuesit, për sa kohë që mësuesi është i dukshëm dhe zëri mund të dëgjohet në video. Nga ana tjetër, do të ishte e vështirë të vëzhgoni raportin e mësuesit me nxënësit nëse nuk arrini t'i shihni nxënësit në video.

Kjo detyrë ju ndihmon të zhvilloni vizionin tuaj profesional. Duke njohur elementet më të domosdoshme, përmbajtja thelbësore e videos është mjaft e thjeshtë nëse prodhimi i videos ka patur të njëjtin fokus të pandryshueshëm gjatë gjithë gjatësisë së saj. Nëse videoja është një pamje e gjerë e një klase, ku janë duke ndodhur dhjetëra gjëra në të njëjtën kohë, është tejet më e vështirë të vësh re dhe të identifikosh ato ngjarje ose seri veprimesh që mund të jenë relevante.

Për shembull, videoja [Mësimi i Gjuhës Angleze Profesionale](#) ka standarde shumë të ulëta sa i takon prodhimit. Në thelb është një regjistrim me telefon me rezolucion tejet të ulët. Sidoqoftë, kjo tregon se të nxënës mund dhe do të zhvillohet jashtë klasës tradicionale.

Mundohuni të analizoni videon dhe të merrni parasysh pyetjet në **Detyrën mësimore 3.1**.

Detyrë mësimore 3.2: Mentorimi i të ngjashmëve dhe diskutimi në grup

Rezultatet e të nxënës:

Ju

- ndani mendimet në grup për të dalë me një perceptim të përbashkët të praktikave të mira në mësimdhënie

Uluni së bashku me kolegët tuaj mësues ose kandidatët për mësues, shikoni videon që paraqet një orë mësimi tuajën (**Detyra mësimore 2(2)**) dhe reflektoni në lidhje me aktivitetet tuaja mësimdhënëse bazuar në ato që keni parë në video.

Në varësi të gjatësisë së videos dhe madhësisë së grupit tuaj ju nevojiten rreth 30-60 minuta për këtë aktivitet. Diskutoni së bashku se çfarë po përpiqeni të arrini. Qëllimi është të zhvilloni veten - dhe jo të kritikoni cilindo që shfaqet në këtë video. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse personi në video është një nga njerëzit e pranishëm në dhomë. Ky ushtrim ka të bëjë me dallimin e gjërave të veçanta në video dhe më pas reflektimin e tyre në praktikën tuaj bazuar në këtë shembull vizual.

Ky aktivitet mund të çojë në ndjekjen e veprimtarisë tuaj mësimdhënëse në video e cila është sigurisht më sfiduese pasi ne priremi të mbikritikojmë veten tonë dhe të përqendrohemi në detaje jo thelbësore.

Mbani shënime gjatë ndjekjes së videos. Mundohuni të shkruani vëzhgimet tuaja në mënyrë sa më neutrale: çfarë ndodhi në video dhe cili ishte reagimi juaj ndaj asaj që ndodhi? Mos dilni me konkluzione apo interpretime të nxituara.

Pasi të shikoni një pjesë ose të gjithë videon dhe pasi të keni marrë shënime, diskutojini dhe krahasojini ato në grup. Çfarë patë? Si reaguat ndaj saj? Si do ta menaxhoni një detyrë ose situatë të ngjashme? Gjithsecili mund të japë mendimin e tij/saj duke e kombinuar me mendimet e të tjerëve.

lidhje me mënyrën e dhënies së mendimit dhe reflektimit më pas. Nëse qëllimi është zhvillimi i praktikave pedagogjike, është thelbësore të përqendroheni në sjellje të të caktuara mësimdhënëse ose në rezultatet e dëshiruara të të nxënit.

Duhet ta pranojmë që vëzhgimin dhe interpretimin i ndan një vijë e hollë dhe të dallosh njërin aktivitet nga tjetri është sfidë më vete. Në jetën e përditshme është mjaft e zakonshme të dilni me përfundime dhe të bëni interpretime pa sqaruar se si kanë ndikuar përvojat dhe preferencat tuaja personale në procesin e të menduarit. Është e lehtë të shprehni mendimin tuaj duke thënë "Më pëlqeu" ose "Kjo nuk ishte shumë mirë". Por, kur bëhet fjalë për vlerësimin dhe dhënien e mendimeve cilësore, këto mendime duhet të lidhen me vëzhgime të besueshme dhe kriterë ekzistuesë. Sidomos në botën e arsimit ose veçanërisht në rastet kur ekspozoni punën tuaj para kolegëve tuaj, është shumë e rëndësishme që të mos shprehni mendimin tuaj në mënyrë rastësore. Vlerësimi dhe mendimet cilësore kanë një fokus të veçantë dhe bazohen në një sërë kriteresh dhe duhet të përfshijnë të menduarit etik që merr parasysh personin që pret këtë mendim dhe qëllimin e veprimtarisë mësimore.

Gjërat që duhen patur parasysh

Tipari dallues i të nxënit nga të ngjashmit është vizioni profesional kolektiv dhe procesi bashkëpunues i reflektimit.

Videoja mund të krijohet nga kushdo dhe nuk është e nevojshme që të shfaqë punën e njërit prej pjesëtarëve të grupit.

Në përgjithësi, është më e lehtë të fillosh me një video që nuk paraqet një orë mësimi tuajën. Me kalimin e kohës ia vlen të bëni një zhvendosje dhe të filloni të vëzhgoni mësimet tuaja. Diskutimi në mënyrë kritike i veprimtarisë mësimdhënëse mund të jetë edhe më i lehtë nëse asnjëri nga personat e grupit nuk shfaqet në video. Ekspozimi i punës tuaj dhe i reflektimeve tuaja tek të tjerët kërkon vetëvlerësim dhe besim të lartë në rradhët e pjesëmarrësve. Nëse një grup është duke parë videon e njërit nga pjesëmarrësit, është mirë të bien dakord në

VIZIONI
PROFESIONAL



Figura 4. Ndjekja e një veprimtarie mësimdhënëse në video dhe diskutimi në lidhje me të.

KAPITULLI 4: VIDEOT DEMONSTRUESE DHE MIKRO-MËSIMET

Në këtë kapitull do të mësoni se si të realizoni videot udhëzuese (*how-to*) dhe si të regjistroni leksione dhe të jepni mësim përmes 'regjistrimit në ekran'.

Detyrë mësimore 4.1: Krijoni një video udhëzuese (*how-to*) për nxënësit tuaj

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- i mësoni nxënësve një aftësi ose se si të kryejnë një detyrë të caktuar me anën e një videoje mësimore
- planifikoni dhe rendisni imazhet lëvizëse dhe tekstin ose udhëzimet me gojë/zë

Zgjidhni një detyrë ose një aftësi të thjeshtë dhe krijoni një video udhëzuese (*how-to*).

Kanali *YouTube* është plot me video të tilla udhëzuese të cilat janë realizuar nga kompani dhe përdorues individualë. Videot udhëzuese (*how-to*) demonstrojnë mënyrën se si të kryeni një detyrë specifike, si të mësoni një aftësi të caktuar, madje edhe si të përdorni një metodë të caktuar mësimore. Së pari zgjidhni detyrën ose aftësinë që dëshironi t'ju mësoni nxënësve.

Zgjidhni një detyrë manuale që zhvillohet në një mjedis të aksesueshëm, p.sh. një kuzhinë, një repart pune apo një pikë servisi. Nëse kjo është videoja juaj e parë udhëzuese (*how-to*), zgjidhni një detyrë të thjeshtë.

Bëni një plan. Ndajeni detyrën që po filmoni në pjesë ose faza më të shkurtra, njësoj sikur po shkruani hapat e një recete për përgatitjen e një pjate të caktuar. Nëse pjesë të ndryshme kanë nevojë për tekst ose titra, shkruajini edhe ato. Ju mund të dëshironi t'i shoqëroni ose zëvendësoni titrat me një përshkrim me zë (ose rrëfim). Përdorimi i një tabele ku janë përshkruar hapat e regjistrimit të këtij materiali filmik është një mënyrë e dobishme për të planifikuar realizimin e këtij lloji materiali. Zëri shoqërues mund të regjistrohet gjatë filmimit ose më pas në fazën e pas-prodhimit.

Nëse detyra është shumë e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, ju mund ta mbaroni atë vetëm me një regjistrim të pandërprerë. Shumë shpesh është më efektive dhe praktike të filmoni të paktën disa sekuenca dhe të përdorni madhësi të ndryshme fotografish. Kjo do të thotë që ju duhet t'i redaktoni klipet së bashku.

Realizoni videon tuaj, ruajeni dhe transmetojeni për ta parë. Redaktoni videon duke përfshirë tekstin dhe audion. Ju mund të përdorni programe kompjuterike si [Adobe Spark](#), [DaVinci Resolve](#) ose [HitFilm Express](#).

Informacion i mëtejshëm

Para se të filloni të realizoni videon tuaj, përpikuni të gjeni video udhëzuese (*how-to*) të fushës tuaj. Ju mund të kërkontë në *YouTube* dhe në faqet e kompanive, në lidhje me produkte të veçanta. Disa kompani mund të kenë edhe kanalën e tyre në *YouTube*.



Figura 5. Një pamje nga një video udhëzuese (*how-to*) Udhëzime për përdorimin e kameras Sony HDR AX2000.

Gjërat që duhen patur parasysh

Rishikoni videon tuaj udhëzuese. A shfaqeni ju apo persona të tjerë në video, apo ishte krejtësisht jopersonale? A keni përdorur një larmi planesh, inkuadrim nga afër, shënime shpjeguese, rrëfim apo tituj? A mendoni se ritmi i videos është i duhuri, jo shumë i ngadaltë ose jo shumë i shpejtë?

Nëse videoja synon të nxisë një aktivitet të veçantë, ajo duhet të shprehet qartë në video ose në udhëzimet e veçanta. Një video e vetme mund të përdoret në mënyra të ndryshme. Ndonjëherë ka më shumë kuptim të shkruani disa nga udhëzimet në një hapësirë të veçantë teksti dhe jo t'i hidhni ato në video. Një video udhëzuese (*how-to*) për një ushtrim të caktuar mësimor mund t'i ndihmojë nxënësit për të përparuar menjëherë në detyrën e tyre. Një video e vetme mund të shërbejë për qëllime të shumta në varësi të mënyrës dhe kohës kur ajo përdoret në procesin mësimor. Për shembull, një grup nxënësish mund të përdorin videon [Metoda Jigsaw](#) si udhëzim për punën e tyre aktuale në ekip. Një kandidat për mësues mund të përdorë të njëjtën video për të mësuar në lidhje me metodat e ndryshme mësimore.

Detyrë mësimore 4.2: Testoni videon tuaj udhëzuese (*how-to*)

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- testoni nëse videoja juaj funksionon në praktikë
- përmirësoni videon

Kërkojini një kolegu ose një nxënësi të shikojë videon tuaj dhe të kryejë detyrën e udhëzuar në të. Kërkoni mendimin e tyre: A duhet të shpjegohet ndonjë gjë më me kujdes? A tregon videoja gjithçka që duhet të shihet? A është videoja shumë e gjatë?

Nëse duhet të ndryshoni diçka në video kthejuni redaktimit dhe bëni ndryshimet e nevojshme.

Gjërat që duhen patur parasysht

Edhe pse vlera e lartë e prodhimit nuk është qëllimi kryesor i videos për zhvillimin profesional, kjo nuk do të thotë se, me kalimin e kohës, videot nuk duhet të zhvillohen nga ana cilësore. Përdorshmëria e materialeve në internet duhet të kihet gjithmonë parasysht. Nëse nga komentet dhe mendimet e përdoruesve rezulton se ka gjëra që nuk funksionojnë ose për ndonjë arsye videoja nuk po i ndihmon, atëherë është koha për të bërë disa ndryshime.

Një këshillë që duhet patur parasysht është që videoja duhet të jetë e shkurtër. Për shembull, gjatësia e videos udhëzuese (*how-to*) duhet të jetë rreth 2-5 minuta dhe jo 10 minuta. Për shkak të kohëzgjatjes së tyre të shkurtër, këto video konsiderohen si "mikro-mësime". Mjafton një mesazh i rëndësishëm për çdo video.

Nëse videoja mësimore zgjat shumë dhe ka shumë shpjegime, gjasat që shikuesit të jenë të përqendruar janë më të pakta, sidomos në rastet kur nxënësit e shikojnë videon vetëm ose kur të gjejnë kohë. Nga pikëpamja arsimore kjo është një sfidë: mësuesit nuk duan ta pranojnë idenë që nxënësit e tyre mund të kenë interes dhe të përqendrohen vetëm për disa minuta njëherësh.

Sidoqoftë, këshilla në lidhje me realizimin e videove të shkurtra është një këshillë mjaft e dobishme. Videot më të shkurtra nuk marrin shumë kohë për tu prodhuar. Përqendrimi i qartë në përmbajtjen thelbësore dhe organizimi i detyrës mësimore në njësi më të vogla janë të dobishme për nxënësin.

Shikoni videot e mëposhtme dhe përcaktoni se sa të suksesshme janë ato si video udhëzuese (*how-to*):

- [Metoda Jigsaw](#)
- [Si të përdorni: Demonstrim i përdorimit të një Makine të Vjetër Qepëse të markës Singer](#)



Figura 6. Video mësimore [Leksioni i Mirë](#).

Detyrë mësimore 4.3: Përgatituni për një mësim ose leksion që do të regjistrohet për përdorim në internet

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- përgatiteni për një video-leksion
- prodhoni një video-leksion
- ngarkoni videon në internet

Gjeni se çfarë pajisjesh dhe programesh kompjuterike përdoren në institucionin tuaj për video-leksionet. Sigurohuni që keni pajisjet, programet dhe autorizimin e nevojshëm për të regjistruar mësimin ose leksionin tuaj. Kushtojini vëmendje të veçantë lejes për të shfaqur fytyrat dhe emrat e nxënësve në regjistrimin përfundimtar; ose hiqini emrat dhe fytyrat gjatë redaktimit. Gjeni informacion në lidhje me mënyrën e publikimit të një leksioni të regjistruar. Vendosni kamerat dhe mikrofonin tuaj siç përshkruhet në detyrat e mëparshme mësimore. Regjistroni një video-leksion dhe publikojeni në internet.

Alternativa të tjera

Përgatitni një video-leksion të llojit *screen capture* duke përdorur mjete e duhura për këtë qëllim.

Gjeni një program kompjuterik të përshtatshëm në internet për të realizuar video të tilla. Mjetet e video-konferencave si Adobe Connect, Zoom dhe Skype kanë një funksionalitet regjistrimi në to.

Kontrolloni videot ekzistuese të këtij lloji të krijuara nga të tjerët dhe përpikuni të kuptoni se cilat elemente janë realizuar me sukses, cilat fusha kanë nevojë për përmirësim.

Duke përdorur mjetet në internet, krijoni një video të shkurtër të llojit *screen capture* ose *screencast* në lidhje me fushën tuaj dhe më pas hidhjeni atë në një server në internet.

Gjërat që duhen patur parasysht

Video-leksionet janë të dobishme veçanërisht për ata persona që duan t'i rishikojnë mësimet. Rishikimi i materialit studimor është një pjesë thelbësore e çdo procesi mësimor. Video-leksionet mund t'i ndihmojnë edhe nxënësit të cilët nuk mund të jenë fizikisht të pranishëm në mësim.

Për një mësues video-leksionet mund të kursejnë kohë dhe të ndihmojnë për të arritur tek një audiencë më e gjerë. Për shembull, në modelin e klasës së rokulisur (*flipped classroom*), videoja shpesh krijohet për diçka që përndryshe do të ligjërohej në mënyrë të përsëritshme në klasë. Ndjekja e një leksioni të regjistruar mund të çojë në kursim të kohës e cila, nga ana tjetër, mund të përdoret në mënyrë më fleksibël për ushtrime dhe udhëzimin e nxënësve. Materialet e mira filmike (video) mund të ripërdoren disa herë dhe nga mësues të ndryshëm.

Video-leksionet mund të prodhohen nga një grup i madh mësuesish, sidomos në organizatat më të mëdha arsimore. Nuk është e nevojshme që të gjithë mësuesit të realizojnë videot e tyre. Koleksioni i madh i video-leksioneve është shtylla kurrizore e MOOC (kurs masiv i hapur online) dhe e shumë kompanive që ofrojnë kurse në internet.

Regjistrimi i leksioneve është ndoshta forma më e zakonshme dhe e thjeshtë e videos mësimore. Në këtë rast bëhet fjalë vetëm për një regjistrim të mësimdhënies, me pak ose aspak modifikim më pas. Në trajnimin e mësuesve, regjistrimi i leksioneve mund të përdoret edhe për të dokumentuar kompetencën e mësimdhënies ose në të njëjtën mënyrë ajo mund të përdoret për reflektim dhe vëzhgim (detyrat në **Kapitullin 2 dhe 3**). Regjistrimi i leksioneve dhe seminarët në internet (*webinar*) mund të përdoren për të dhënë mësim nga

distanca. Seminarët në internet janë kthyer në një praktikë shumë të zakonshme për të arritur tek një audiencë më e gjerë dhe për të kursyer koston e udhëtimit. Shumë kompani, institucione arsimore, organe kombëtare dhe organe të BE-së organizojnë seminare në internet rregullisht për të informuar dhe ndihmuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

Ndiqui minutat e para të një videoje:

[Create tutorial - Wink](#) dhe përgjigjuni pyetjeve:

- A ka nevojë videoja edhe për rrëfim?
- A ishte udhëzuese dhe a mësuar gjë prej saj?
- Si do ta ndryshonit videon për ta bërë më të mirë?



Figura 7. Duke ndjekur një leksion në internet.

VIDEOT
DEMONSTRUESE

VIDEOT
NË
INTERNET

KAPITULLI 5: VIZIONI PROFESIONAL

Ky kapitull trajton vlerësimin dhe gjykimin në lidhje me video-pedagogjinë dhe materialet filmike. Ju mësoni se si të përdorni mjetet për shënimet shpjeguese të videos për ta pasuruar atë dhe për të angazhuar nxënësit.

Detyrë mësimore 5.1: Vlerësimi i videos

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- vlerësoni cilësinë e materialit mësimor
- zhvilloni vizionin profesional në lidhje me videot
- propozoni përmirësimin e materialeve mësimore

Ndihni videon e shkurtër [Një shembull i mësimdhënies së dobët](#). Çfarë e bën këtë mësimdhënie të dobët? Çfarë e bën këtë një video të dobët? Kushtojini vëmendje punës së kamerave, rezolucionit, mprehtësisë, cilësisë së audios, ndriçimit, montazhit, shënimeve shpjeguese, etj. Nëse do të ishit pedagog, çfarë do të kishit bërë për ta bërë prezantimin dhe videon më të mirë? Si do t'i përdornit titujt dhe grafikat për ta bërë videon të duket më profesionale?

Gjërat që duhen patur parasysh

Pasi të njiheni me cilësitë pedagogjike, teknike dhe madje edhe ato artistike në video, nëse dëshironi, ju mund të krijoni videot tuaja për të tërhequr një audiencë më të madhe dhe për të rritur impaktin e tyre. Standardet që zbatohen për videot e prodhuara nga nxënësit, videot e prodhuara nga një mësues për nxënësit dhe videot e prodhuara nga organizata ose institucione janë të ndryshme. Ju duhet të vendosni se sa kohë dhe përpjekje do të ishin të arsyeshme për të justifikuar qëllimin dhe audiencën. Mos harroni se i njëjti material filmik (video) mund të rimodifikohet nëse lind nevoja.

Detyrë mësimore 5.2: Shënimet shpjeguese të videos

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- jepni mendimin dhe vlerësimin tuaj nëpërmjet shënimeve shpjeguese të një videoje
- bëni shënime me zë ose me tekst në video

Përfshirja e shënimeve shpjeguese në video funksionon si një mjet vlerësimi dhe reagimi. Ekzistojnë disa programe që ju ndihmojnë që të shtoni shënimet tuaja në formatin video, imazh, audio ose tekst në skedarin e videos. Në këtë mënyrë nuk ju nevojitet të shkruani një tekst të veçantë me komente apo të organizoni një diskutim, pasi

komentet tuaja i bashkangjiten videos.

Përdorni një video që e keni prodhuar më parë. Përqendrohuni në një aspekt të veçantë të mësimdhënies ose kompetencë që mund të shihet në video, p.sh. një pikë me të cilën pajtoheni ose diçka që dëshironi ta vini në diskutim.

Zgjidhni një aplikacion ose një program kompjuterik për shënimet shpjeguese të videove. Shtoni komentet ose pyetjet tuaja në pikat e përzgjedhura në video. Ruani dhe ndajeni videon me të tjerët.

Alternativa të tjera

- Ju mund të përfshini edhe një sondazh në videon tuaj me qëllim angazhimin e shikuesve.
- Ju mund të ftoni nxënësit të shtojnë shënimet shpjeguese në videot e prodhuara nga njëri-tjetri.

Mjetet

- YouTube ende e lejon [shtimin e shënimeve të thjeshta](#) në videon tuaj në kanalin tuaj.
- [AchSo!](#) është një mjet arsimor pa pagesë për shënimet shpjeguese të videove që funksionon me një pajisje doracake.

Gjërat që duhen patur parasysh

Në këtë kontekst, vizioni profesional nënkupton aftësinë e mësuesit për të parë, vërejtur dhe njohur gjërat e rëndësishme dhe kuptimplote (siç është kompetenca) në një video. Një mësues me përvojë i arsimit profesional mund të jetë në gjendje të njohë kompetencën profesionale dhe pedagogjinë e mirë, por ata do të duhet të zgjerojnë vizionin e tyre profesional për të kuptuar karakteristikat e videos dhe çfarë mund të fiksohet dhe të bëhet me anë të videos. Përmes përgatitjes dhe praktikës mësuesit mund të mësojnë të shohin se çfarë funksionon mirë dhe mënyrën se si video po forcon mësimdhënien dhe të nxënit ose, të kundërtën, çfarë gabimesh janë bërë.

Në krahasim me një prezantim në klasë, avantazhet e videos janë përsëritshmëria, aksesueshmëria (audiencë më e gjerë) dhe mundësia për të bërë komente nëpërmjet shënimeve shpjeguese. Nga ana tjetër, videos së regjistruar, edhe kur shoqërohet me këto shënime, i mungon ndërveprimi kur krahasohet me mësimin ballë për ballë ose mësimin në klasë.

Shoqërimi i videos me shënimet shpjeguese i shton asaj disa shtresa të tjera informacioni, duke tërhequr vëmendjen për pika specifike. Këto shënime mund të jetë në formën e tekstit, formave, grafikëve dhe zërit përshkrues (ose rrëfimit). Edhe procesi i realizimit të videos ka mjetet e veta redaktuese, të tilla si montazhi, prerjet, pauzat, planet e gjata, planet e mesme dhe planet nga afër. Kur përdoren ashtu siç duhet, ata e bëjnë më të lehtë marrjen e mesazhit dhe përqëndrimin në mesazhet kryesore.

MENDIMET PËR VIDEON

KAPITULLI 6: PRODHIMI I VIDEOS DHE KRIJIMI I VIDEO- BIBLIOTEKËS

Ky kapitull i fundit merret më shumë me aspektet organizative të prodhimit të videos. Detyrat synojnë të krijojnë më shumë materiale të shkruara filmike dhe të ndërtojnë një kanal ose një faqe interneti, ku mund të mbledhni videot tuaja.

Detyrë mësimore 6.1: Prodhimi i videos

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- krijoni një video me një histori dhe aktorë të shumtë
- përdorni rrëfimin për të kuptuar dhe mësuar nga gabimet

Kërkojuni nxënësve tuaj të regjistrojnë një video që ilustron një numër gabimesh që janë bërë gjatë një projekti, një detyre ose një pune. Videoja do të përbëhet nga disa skena dhe më shumë se një aktor.

Para-prodhimi

Planifikoni një histori dhe shkruajeni skenarin dhe bëni planin e zbatimit. Gjeni dhe renditni të gjithë elementët e nevojshëm për videon (siç janë aktorët, sfondi/ vendndodhja, rekuizitat, muzika dhe ndriçimi).

Vendosni kush do të jenë aktorët, kush do të filmojë (regjistrojë) videon dhe kush do të redaktojë regjistrimin. Keni nevojë për një regjizor? Përcaktoni edhe nëse ju nevojitet personel tjetër (si për shembull teknikët e mikrofonave), sa ndihmës nevojiten për prodhimin (për shembull njerëzit për të lëvizur dritat, për të transportuar aktorët, etj.). Kush është përgjegjës për lejet e ndryshme? Sigurohuni që lejoheni me ligj që të paraqitni pamje të ndryshme në sfond dhe logot e kompanisë në veshjet e njerëzve.

Prodhimi

Pasi të keni përfunduar para-prodhimin, xhironi videon. Vini re se regjistrimi mund të zgjasë disa ditë. Për më tepër, shumë (ose shumica) e skenave do të duhet të regjistrohen më shumë se një herë. Pastaj modifikoni videon, shtoni zërin e mundshëm në sfond, elementet e tekstit ose titrat. Mundohuni të ekuilibroni ngjyrën e videos përfundimtare për të arritur një pamje të nëjtrajteshme. Do të vini re që do t'ju duhet të hiqni shumë nga pamjet e papërpunuara për të gjetur pikërisht ato planet e rralla të përsosura.

Pas-prodhimi

Më në fund, pas shfaqjeve testuese (dhe ri-modifikimeve të mundshme) eksportojeni projektin për t'u parë edhe nga të tjerët. Përdorni videon për të nxitur diskutimin në lidhje me arsyet që qëndrojnë prapa gabimeve dhe si mund të shmangen ato. Diskutoni impaktin e videos.

Alternativa të tjera

Ky projekt mund të modifikohet për të përfshirë të nxënit në lidhje me rregulloret, menaxhimin e njerëzve ose për adresimin e kompetencave të caktuara kyçe.

Gjërat që duhen patur parasysht

Prodhimi i plotë mund të marrë kohë dhe mund të jetë një proces sfidues. Puna në grup mund të jetë stresuese. Asgjë nuk e zë vendin e një planifikimi të mirë. Nëse vendosni t'i kushtoni kohë rrëfimit në video gjatë mësimit, sigurohuni që të gjithë të jenë të ndërgjegjshëm në lidhje me atë që po mësojnë.

Historitë janë një mënyrë e mrekullueshme për të transmetuar një mesazh. Shembujt dhe historitë e bëjnë çdo material mësimor më të gjallë dhe sigurisht që kjo vlen edhe për videon. Ajo është një mjet rrëfimi. Format i rrëfimit na ndihmon të kujtojmë dhe struktura bazë e një historie kuptohet pothuajse nga të gjithë. Njerëzit përfshihen në histori çdo ditë përmes televizionit, videos dhe ndërveprimeve sociale. Historitë mund t'iu referohemi në mënyrë të vazhdueshme.

Shembull i një video: [Intervista për Praktikën Profesionale](#).

Detyrë mësimore 6.2: Video-biblioteka

Rezultatet e të nxënit:

Ju

- krijoni një video-bibliotekë
- bashkëpunoni me kolegët për të ndarë me ta materialet mësimore

Një video-bibliotekë është e dobishme nëse, së bashku me nxënësit tuaj dhe / ose kolegët tuaj, ju keni ndërmend të grumbulloni dhe të shkëmbeni video në të ardhmen. Ju duhet të planifikoni qëllimin e bibliotekës, kush do të përfshihet dhe si.

Hapni një kanal videosh në YouTube ose një faqe në internet që i mbledh të gjitha videot tuaja në një vend. Përfshini kolegët ose nxënësit tuaj. Ndani me të tjerët videot dhe listën e tyre duke përdorur mediat sociale.

Udhëzime

- [Si të hapni një kanal në YouTube](#)
- [Hapni një faqe interneti për blogje në Blogger](#)
- [Hapni një faqe interneti për blogje në Wordpress](#)

Hapat e mëtejshëm

Bëni një plan se çfarë lloj videoje do të prodhoni si organizatë gjatë vitit të ardhshëm. Diskutoni me organizatën tuaj në lidhje me mënyrën e përdorimit të videove në punën tuaj të përditshme. Si mund të përfitojnë të gjithë në maksimum nga përdorimi i tyre?

Nëse keni një kanal në YouTube, mos reshtni së kuruari atë dhe shtoni edhe video të tjera. Mos harroni, nuk është e detyrueshme që videot të bëhen vetëm nga ju, ato mund të prodhohen dhe të ngarkohen në internet edhe nga të tjerët.

Ndani me të tjerët videot tuaja në internet. Tregoni punën tuaj dhe zgjeroni rrjetin tuaj.

Alternativa të tjera

Disa mësues thjesht preferojnë t'i ndajnë videot e tyre me të tjerët përmes mediave sociale, për shembull, në një grup në Facebook. Kjo mund të ketë kuptim nëse videot synojnë të demonstrojnë se çfarë po bëjnë nxënësit ose të shkëmbejnë përvojat. Shumë video nuk kanë për qëllim që të shërbejnë si burime mësimore afatgjata.

Gjërat që duhen patur parasysh

Shumë shpesh organizatat më të mëdha arsimore kanë një strategji për prodhimin e materialeve digjitale që do t'i shërbejnë secilit prej anëtarëve të organizatës në të ardhmen.

Kjo nuk bëhet nga një numër i vogël njerëzish. Qëllimi është përfshirja e një numri të madh të punonjësve në prodhimin ose të paktën përdorimin dhe promovimin e videove.

Video-bibliotekat në internet janë një burim i shkëlqyer për kurset dhe materialet në internet për disa mësues dhe nxënës. Video-biblioteka arsimore mund të promovojë të gjithë shkollën.



Figura 8. Video mësimore [Dimensionet e Mësimdhënies](#).

Pas disa kohësh videot do të vjetërohen. Kanalet e videove ose faqja e internetit të shkollës duhet të kurohen dhe mirëmbahen. Linku mund të prishet dhe madje edhe përmbajtja mund të ndryshojë - veçanërisht nëse jeni duke përdorur linqe të videove të prodhuara nga dikush tjetër.

Videot tërheqin vëmendjen edhe në mediat sociale. Kur një shkollë ose organizatë tjetër arsimore është e pranishme në internet, prodhimi i videos mund të shërbejë si një mjet marketingu për nxënësit dhe klientët e tjerë.

Edhe nëse nuk keni një video-bibliotekë në organizatën tuaj, përsëri është mirë që linqet tuaja të videove të jenë në të njëjtin vend. Ju mund të krijoni kanale me video me lehtësi duke u bazuar në një kurs të vetëm, një temë ose një interes të veçantë.

[Kanali në YouTube](#) i **TedEd** përmban një listë me video mësimore të një cilësie të lartë.

Fondacioni European i Trajnimit përdor dhe mirëmban një [kanal në YouTube](#) për të komunikuar me palët e interesuara dhe partnerët e tyre.

City of Bristol College është një nga kolegjet më të mëdha të arsimit të mëtejshëm në Britaninë e Madhe, të cilët kanë hedhur video në [kanalin e tyre në YouTube](#) gjatë këtyre 10 viteve të fundit.

Cedefop - Qendra Europiane për Zhvillimin e Formimit Profesional - ka mbledhur video në [kanalin e tyre në YouTube](#) që nga viti 2014.

